

Program i trajnimit, me pikësnyim kandidatët, për pozitën e drejtorit për të gjitha tipet e shkollave në Kosovë

## Moduli 1

# Plani zhvillimor i shkollës

# Doracak trajnimi për drejtorët dhe personelin udhëheqës të sistemit arsimor në Kosovë

## Moduli 1 – 7

Hartuar në bashkëpunim ndërmjet projektit të GTZ-së „Reformimi i Arsimit dhe Trajnimit Profesional“ dhe CIMIC-ut Gjerman, Brigada Multinacionale e Jugperëndimit.

Financuar nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) e Republikës Federale të Gjermanisë

Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Teknik (GTZ) GmbH është një ndërmarrje e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim të qëndrueshëm që vepron në mbarë botën. Ajo ofron zgjidhje afatgjate për zhvillimet politike, ekonomike, ekologjike dhe sociale në një botë të globalizuar. GTZ-ja përkrah reformat e ndërlikuara dhe proceset e ndryshimit edhe nën kushte të vështira. Qëllimi i saj është përmirësimi i qëndrueshëm i kushteve jetësore të njerëzve.

### **Botues:**

Projekti Reformimi i Arsimit dhe Trajnimit Profesional në Kosovë  
Rr. Hajrullah Abdullahu nr.25  
10000 Prishtinë – Kosovë

Autor: OTI d.R. Dipl.Päd. H.-W.Baumann

Prishtinë, Dhjetor 2004

# **Doracak për trajnerët**

## Përmbajtja

### **Përmbajtja**

M1-A1 - Hyrje dhe pyetjet mbi të priturat .....	3
M1-A2 - Hapat e zhvillimit të planit zhvillimor shkollor .....	5
M1-A3 - Përfundimi.....	8
M1-A4 - Detyrë praktike .....	9
M1-A5 - Thellimi .....	10
M1-A6 - Testim.....	11

## M1-A1 - Hyrje dhe pyetjet mbi të priturat

### Synimet

- Pjesëmarrësit të kenë një vështrim mbi Temat
- Pjesëmarrësit të jenë në dijeni të sigurt për organizimin e Seminarit
- Pjesëmarrësit të dijnë rëndësin e Temave për vete, për karrierën tyre profesionale dhe të njohin mirëqenien mbarvartëse profesionale
- Pjesëmarrësit të artikulojnë-shprehin parashikimet e tyre aktive dhe personale

### Qëllimet

- Pjesëmarrësit të jenë në vendin e duhur, në organizimin e duhur dhe të kenë dëshirë për bashkëpunim
- Pyetjet e parashikuara të ja mundsojnë instruktorit ecjen përpara të orijentimit në pjesmarrje

### Rjedha

Koha	Tema	Përmbajtjet	Metodat	Ilustrimet
09 <sup>00</sup>	Përshëndetja ,Prezentimi	Përshëndetja,Prezentimi i instruktorit	Ligjerat	Folia # 1
09 <sup>05</sup>	Synimet	<b>Synimi</b> Ju mundeni vetëm ose në bashkëveprim me të tjerët ta zhvilloni një plan zhvillimor shkollor për zhvillimin e Shkollave tuaja	Ligjerat, Diskutimi	Folia # 2
09 <sup>10</sup>	Metodat	<b>Metodat</b> 1.Ligjerat 2.Puna në veçanti 3.Puna në grupe 4.Drejtimi i punës në grupe	Ligjerat, Diskutimi	Folia # 3
09 <sup>15</sup>	Vështrim mbi Kapitujt	<b>Kapitujt</b> 1. Hyrje në pyetjet mbi të priturat nga kz seminar ( Modul) 2. Të identifikohen përparësitë dhe mangësitë 3. Të identifikohen shkaqet e mangësive 4. Të identifikohen pasojat nga mangësitë 5. Definimi i Synimeve (=Zhvillimi i Vizionit) 6. Definimi i Projekteve 7. Të përcaktohen projektet prioritare 8. Përpilimi i planit zhvillimor shkollor 9. Detyrat praktike 10. Përfundim <b>Ndërkohë</b> 11. Thellim 12. Test	Ligjerata, Diskutimi	Folia # 4 Folia # 5 Folia # 6
09 <sup>30</sup>	Organizimi	<b>Detajet Organizative</b> (të përcaktohen në prani) ● Koha ● Ushqimi	Ligjerata	Flip

M1-A1 - Hyrje dhe pyetjet mbi të priturat

		<ul style="list-style-type: none"><li>● Shfrytëzimi i materialit mësimor</li><li>● Regullat e lojës për punë</li><li>● etj.</li></ul>		
09 <sup>40</sup>	Pyetjet e pritura	<b>Pyetjet e pritura</b>	Kartat e pyetjeve	Tabela, Kartuçat, Kolegji
10 <sup>15</sup>	Pauza			

## M1-A2 - Hapat e zhvillimit drejt planit zhvillimor të shkollës

### Synimi

Pjesëmarrësit munden vetë dhe në bashkëveprim me të tjerët ta zhvillojnë planin shkollor për shkollën e tyre

### Qëllimi

Pjesëmarrësit të jenë në gjendje, që në funksionin e Drejtorit të shkollës ta zhvillojnë një plan shkollor

### Rjedha

Koha	Tema	Përmbajtja	Metoda	Ilustrimet
1030	Hyerje	Synimi, Qëllimi	Ligjerata	Folia # 1 Folia # 2 Folia # 3
1040	Përshkrimi i përparësisë dhe i mangësis të shkollave	<p><b>Hapi i parë:</b> Pjesëmarrësit të përpunojnë përparësitë dhe mangësin e një shkolle të imagjinuar. Pjesëmarrësit të cilët vijnë nga shkollat e ndryshme këtu duhen të cekin përparësit dhe mangësit e shkollës së tyre. Si rezultat do të përpilohet një listë e mundur me përparësit dhe mangësit.</p> <p>Instruktori përdor</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Tabelën-Përparësitë / Mangësit</li> <li>Kategorit - këtu të vendos si që vijon: Cilat përparësit i ka shkolla ime në lëmit 1.1.e Metodave të mësimi ? Cilat mangësit i ka shkolla ime në lëmit 1.1.e Metodave të mësimi ?</li> </ol> <p>Cilat përparësi i ka shkolla ime në lëmit 1.2. e ofertave të lëndëve mësimore ? Cilat mangësit i ka shkolla ime në lëmit 1.2. e ofertave të lëndëve mësimore ?</p> <p>etj.</p> <p>Zgjedhja e Metodave i është lënë Instruktorit</p>	Ligjerata, Diskutimi, Puna në grupe	Folia # 4 Folia # 5 Folia # 6 Folia # 7 Folia # 8  Flip, Tabela. Tabela
1200	Pauza e Drekes			



Koha	Tema	Përmbajtja	Metoda	Ilustrimet
1300	Definimi i Projektit	<p><b>Hapi i Pestë:</b> Tani duhet të përshkruhen rrugët e Synimeve. Pyetja: Si arrihet një Synim ? Përgjegja: Me një Projekt</p> <p>Udhëzimi:</p>	Diskutime, Grupet e Punës	Flip, Tabla. Tabelë Folia # 13
1430	Pauza			
1500	Projektet prioritare	<p><b>Hapi i Gjashtë:</b> Tani do të përpilohet një list ndoshta nga 10 ose 20 Projekte. Zhvillimi i të gjitha Projekteve mbingarkon ndoshta mundësit e shkollave. Për këtë arsye tani duhen Projektet më të rëndësishme të përcaktohen. <b>Pyetja:</b> Cilat janë Projektet më të rëndësishme?</p> <p>Udhëzimi: Njerëzit bëjnë punën e preferuar që ata e mbizotërojnë dhe e duan.</p> <p>Pjesmarësit pra do të ishin lutur që ta bëjnë një renditje të projekteve në projektin e parë të rëndësishëm, të dytin e kështu me radhë. Kështu që të fitohet një varg renditje personale.</p> <p>Për këtë duhet të ofrohet një Kriterium i vlersuar.</p> <p><b>Kriterium për renditje:</b> rezultatet e pritura në shkolla</p>	Votimi me Pika	Flip, Tabela
1640	Vazhdim me M1A3			

## M1-A3 - Detyrë praktike

Rjedha

1640	Detyrë praktike	<b>Hartoni një plan zhvillimor shkollor për shkollën tuaj</b> Plani zhvillimor shkollor duhet ti përmbaj së paku 10 projekte.	Ligjërime	Folia # 2
1700	Vazhdim me M1A4			

## M1-A4 - Përfundimi

## Rjedha

Koha	Tema	Përmbajtja	Metoda	Ilustrimet
1700		<ul style="list-style-type: none"> <li>● Përmbledhja e përbashkët</li> <li>● Krahasimi me rrjedhat e pritura</li> <li>● Vlerësimi i përmbajtjeve dhe Metodave me pjesmarrësit me qëllim të përmirësimit të konceptit</li> <li>● Vështrim në ditët e ardhëshme dhe në Modulet e përfunduara</li> <li>● Përshëndetja</li> </ul>		Folia M1A4

Fillimi i fazës në mes të dy seancave

Dita e tretë më: ...

## M1-A5 - Thellimi

### Qëllimi

Pjesëmarrësit kanë rastin që së bashku me trajnerët dhe kolegët të thellohen më tej në materialin e trajtuar në dy ditët e para të modulit dhe të thellojnë më tepër njohuritë gjatë kohës mes dy seancave dhe me anë të detyrës praktike.

### Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtjet	Metodat	Ilustrimet
0900	Hyrje	Qëllimi	Ligjërime	
0905		<ul style="list-style-type: none"> <li>•Ligjërime dhe diskutime të moderuara të rasteve praktike, me ç'rast edhe shkëmbim kolegial të përvojave</li> <li>•Diskutime të thelluara mbi materialin mësimor</li> </ul>		Folie # 2
1600	Vazhdim me M1A6			
1700	Fund			

## M1-A6 - Testim

Test

**Mbiemri:**

**Emri:**

**Data:**


**Udhëzim për zhvillimin e testit:**

Pikat kanë së paku dy mundësi të zgjidhjes.

Prej tyre së paku njëra është e saktë.

Vini një kryq në mundësitë e sakta të zgjidhjes.

Në rast se keni vënë kryqin në një mundësi të gabuar, atëherë hiqni një vijë nëpër kuti:

 Teksti i përgjigjes...

Testin e kaloni nëse i përgjigjeni saktësisht gjashtë pikave prej gjithësej tetë.

**1: Në fillim të punës për zhvillimin e një plani të zhvillimit shkollor qëndron hulumtimi i pikave të forta dhe të dobëta të shkollës Suaj. Pikat e forta dhe dobësitë**

- kërkohen vetëm në lëminë e „mësimit“, sepse kjo është sfera më e rëndësishme e shkollës në përgjithësi.
- kërkohen në të gjitha sferat e shkollës.
- i raportohen Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, në mënyrë që të mund të vlerësohet drejtori dhe mësime të tjerë.

**2: Pasi të identifikohen pikat e forta dhe dobësitë e shkollës, kërkohen shkaqet për dobësitë.**

**Ta zëmë se në shkollën Tuaj mungojnë shumë nxënës në mësim. Cila prej shkaqeve direkte mund të jetë e saktë?**

- Shumë nxënës, të cilët nuk vijnë në mësim, kanë probleme në transportim. Prindërit kanë frikë se mos po i ndodhë diçka fëmijëve të tyre gjatë rrugës për në shkollë, nëse ata duhet të ecin.
- Nuk ndodhë asgjë në rast se një nxënës nuk vie në mësim. Me gjithë detyrimin ligjor për shkollë, prindërit nuk detyrohen t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë.
- Vlerësimi statistikor i mospranisë në mësim i raportohet Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji.

**3: Për dobësitë e gjetura përshkruhen edhe ndikimet dhe konsekuencat e tyre. Kjo na lejon të vlerësojmë,**

- se çfarë domethënie ka ajo dobësi për funksionimin e shkollës.
- cila dobësi më së miri do të duhej të mënjanohet para të tjerave.
- sa të holla dhe personel duhet të vehen në përdorim për t'a mënjanuar dobësinë.

4: Nga dobësitë duhet të rrjedh një qëllim. Cila nga formulimet vijuese nuk është e dobishme?

- Duhet të ndërpritet lëshimi i mësimit.
- Të gjithë nxënësit - me përjashtim të disa rasteve të pakta - do t'i bëjmë, t'i vizitojnë mësimit rregullisht.
- Deri në përfundim të vitit të ardhshëm shkollor, kuota e mospranisë në mësimit do të ulet për 3% ose edhe më pak

5: Një qëllim arrihet përmes

- një projekti, në të cilin janë të planifikuara me kujdes të gjitha masat e nevojshme.
- konferencave të mësimitdhënësve, të cilat mbahen çdo javë.

6: Në planin e zhvillimit shkollor janë të futura në listë projekte të shumta, të cilat duhet të zbatohen në afat të mesëm. Nëse vështrohen të gjitha synimet e projekteve së bashku, atëherë krijohet

- një pasqyrë e shkollës (vizion), se si ajo do të duhej të ishte në të ardhmen.
- një vizion i arsimit.

7: Plani i zhvillimit shkollor është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e funksionimit të shkollës. Për këtë arsye ai

- hartohet vetëm nga ana e drejtorit. Ai pastaj i jep porositë mësimitdhënësve, në mënyrë që plani i zhvillimit shkollor të zbatohet në realitet.
-

hartohet vetëm nga rrethi i njerëzve, i cili është i prekur nga problemet më të mëdha të shkollës. Me këtë dëshirohet të arrihet që motivimi të jetë veçanërisht i lartë.

- hartohet nga sa më shumë persona që të jetë e mundur nën udhëheqjen e drejtorit.

**8: Plani i zhvillimit shkollor është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e funksionimit të shkollës. Ai parashtron dobësitë e shkollës. Për këtë arsye a do të duhej**

- që për të të vëhet në dijeni vetëm një rreth i ngushtë njerëzish i përbërë prej mësuesve, nxënësve, prindërve dhe opinionit në përgjithësi të mos arrijnë informata, të cilat mund të dëmtojnë emrin e shkollës?
- që ai t'i parashtrahet të gjithë të të interesuarve e veçanërisht prindërve dhe mësuesve, në mënyrë që të tregohet se është duke u punuar seriozisht në përmirësimin e funksionimit të shkollës dhe të kërkohet përkrahja e tyre?

## Zgjidhjet

1	
	x

2	
	x
	x

3	
	x
	x

4	
	x
	x

5	
	x

6	
	x

7	
	x

8	
	x